



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L – 040 për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L –144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 20, paragrafi 2 të Rregullores QRK nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe të nenit 33.2, shkronja a dhe nenit 34.1 shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.nr. 110-391, të dt.25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 12.10.2018, miratoi këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme - objektit të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, pa procedurë konkurrimi.
- II. Objekti në pronën e paluajtshme, i dhënë në shfrytëzim, i cekur në pikën I, gjendet në parcelën kadastrale nr. 06204-1, Zona kadastrale Prishtinë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 774 m².
- III. Qëllimi dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën II të këtij vendimi , është për nevojat e Bankës Qendrore të Kosovës
- IV. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të objektit në pronën e paluajtshme Komunale, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, është afatgjatë për 20 vjet.
- V. Objekti në pronën e paluajtshme komunale e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të objektit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VII. Objekti në pronën e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastral të Komunës.
- VIII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës..
- IX. Pjesë përbërëse e këtij propozimvendimi janë:
 - Skica grafike
 - Kopja e planit dhe certifikata e pronës

X. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/06-249548/18, më 15.10.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

